LIGJI NR. 10/L-005

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJE SË KREDISË NË MES TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCAVE, PUNËS DHE TRANSFEREVE, DHE ASOCIACIONI NDËRKOMBËTAR PËR ZHVILLIM PËR PROJEKTIN "KOMPAS" - QASJA GJITHËPËRFSHIRËSE E KOSOVËS PËR FORCIMIN E SISTEMIT TË SHËNDETËSISË

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në mbështetje të neneve 18 dhe 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton:

LIGJ PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË KREDISË NË MES TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCAVE, PUNËS DHE TRANSFEREVE, DHE ASOCIACIONI NDËRKOMBËTAR PËR ZHVILLIM PËR PROJEKTIN "KOMPAS" - QASJA GJITHËPËRFSHIRËSE E KOSOVËS PËR FORCIMIN E SISTEMIT TË SHËNDETËSISË

Neni 1
Qëllimi

Ky Ligj ka për qëllim ratifikimin e Marrëveshjes së Kredisë në mes të Republikës së Kosovës përfaqësuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, dhe Asociacioni Ndërkombëtar për zhvillim për projektin "Kompas" - Qasja Gjithëpërfshirëse e Kosovës për Forcimin e Sistemit të Shëndetësisë."

Neni 2
Ratifikimi i Marrëveshjes

1. Ratifikohet Marrëveshja e Kredisë në mes të Republikës së Kosovës përfaqësuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Asociacioni Ndërkombëtar për projektin "Kompas" -Qasja Gjithëpërfshirëse e Kosovës për Forcimin e Sistemit të Shëndetësisë".

2. Objektivi kryesor i këtij projekti është forcimi i kapaciteteve institucionale dhe qeverisjes për cilësinë e kujdesit në sistemin e shëndetësisë të Kosovës.

3. Marrëveshja përfshin forcimin e pjesëve përbërëse të sistemit shëndetësor me rëndësi kyçe për cilësinë e kujdesit, zhvillimin e Sistemit të Integruar Informativ Shëndetësor ("SIISH"), si dhe komponenta e tretë për menaxhimin, monitorimin dhe vlerësimin e projektit.

4. Marrëveshja e Kredisë kap vlerën totale prej EUR 18,600,000. Kjo do t'i mundësoj Qeverisë së Kosovës forcimin e pjesëve përbërëse të sistemit shëndetësor me rëndësi kyçe për cilësinë e kujdesit, zhvillimin e Sistemit të Integruar Informativ Shëndetësor ("SIISH"), si dhe komponenta e tretë për menaxhimin, monitorimin dhe vlerësimin e projektit.

Neni 3
Dokumentet e bashkëngjitura

Bashkëngjitur me këtë Ligj është Marrëveshja e Kredisë në mes të Republikës së Kosovës përfaqësuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Asociacioni Ndërkombëtar për projektin "Kompas" - Qasja Gjithëpërfshirëse e Kosovës për Forcimin e Sistemit të Shëndetësisë."

Neni 4
Hyrja në fuqi

Ky Ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 10/L-005
13 shkurt 2026

Shpallur me dekretin Nr. DL-21/2026, datë 23.02.2026 nga Presidentja e Republikës së Kosovës Vjosa Osmani-Sadriu

*Ligji nr. 10/L-005 "Për Ratifikimin e Marrëveshjes së Kredisë në mes të Republikës së Kosovës përfaqësuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, dhe Asociacioni Ndërkombëtar për zhvillim për projektin "Kompas" - Qasja Gjithëpërfshirëse e Kosovës për Forcimin e Sistemit të Shëndetësisë" bashkangjitur me marrëveshje janë publikuar në web faqen e Gazetës Zyrtare (gzk.rks-gov.net)

KREDIA NUMËR 75410-XK

Marrëveshja e Financimit

**(KOMPAS - Qasja Gjithëpërfshirëse e Kosovës
për Forcimin e Sistemit të Shëndetësisë)**

ndërmjet

REPUBLIKËS SË KOSOVËS

dhe

ASOCIACIONI NDËRKOMBËTAR PËR ZHVILLIM

MARRËVESHJA E FINANCIMIT

MARRËVESHJE që mban datën e Datës së Nënshkrimit ndërmjet REPUBLIKËS SË KOSOVËS ("Marrësi") dhe ASOCIACIONIT NDËRKOMBËTAR PËR ZHVILLIM ("Asociacioni") Marrësi dhe Asociacioni dakordohen për sa më poshtë:

NENI I — KUSHTET E PËRGJITHSHME; PËRKUFIZIMET

1.01. Kushtet e Përgjithshme (siç përcaktohen në Shtojcën e kësaj Marrëveshje) zbatohen dhe janë pjesë e kësaj Marrëveshje.

1.02. Përveç nëse konteksti e kërkon ndryshe, termat e shkruar me shkronjë të madhe dhe të përdorura në këtë Marrëveshje kanë kuptimet që u janë dhënë në Kushtet e Përgjithshme ose në Shtojcën e kësaj Marrëveshje.

NENI II — FINANCIMI

2.01. Asociacioni dakordohet t'i japë Marrësit një kredi, e cila konsiderohet si Financim Koncesionar për qëllimet e Kushteve të Përgjithshme, në shumë prej tetëmbëdhjetë milionë dhe gjashtëqind mijë eurosh (18,600,000 EURO), siç mund të konvertohet kjo shumë kohë pas kohe përmes Konvertimit të Monedhës (varësisht, "Kredi" dhe "Financim"), për të ndihmuar në financimin e projektit të përshkruar në Skedulin 1 të kësaj Marrëveshje ("Projekti").

2.02. Marrësi mund t'i tërheqë të ardhurat nga Financimi në përputhje me Seksionin III të Skedulit 2 të kësaj Marrëveshje.

2.03. Norma Maksimale e Ngarkesës së Zotimit është gjysma e një për qind (1/2 e 1%) në vit sipas Bilancit të Financimit të Patërhequr.

2.04. Ngarkesa e Shërbimit është më e madhja nga: (a) shuma prej tre të katërtave të një për qind (3/4 e 1%) në vit plus Rregullimin e Bazës për Ngarkesën e Shërbimit; dhe (b) tre të katërtat e një për qind (3/4 e 1%) në vit; sipas Bilancit të Kredisë së Tërhequr, ose me kursin që mund të aplikohet pas Konvertimit të Monedhës.

2.05. Ngarkesa e interesit është më e madhja nga: (a) shuma prej një pikë njëzet e pesë për qind (1.25%) në vit plus Rregullimin e Bazës për Ngarkesën e Interesit; dhe (b) zero për qind (0%) në vit, ose me kursin që mund të aplikohet pas Konvertimit të Monedhës; sipas Bilancit të Kredisë së Tërhequr.

2.06. Datat e Pagesës janë 15 marsi dhe 15 shtatori i çdo viti.

2.07. Shuma e principalit të Kredisë shlyhet në përputhje me planin e shlyerjes të përcaktuar në Skedulin 3 të kësaj Marrëveshje.

2.08. Monedha e pagesës është Euro.

NENI III — PROJEKTI

3.01. Marrësi deklaron angazhimin e vet ndaj objektivave të Projektit. Për këtë qëllim, Marrësi e realizon Projektin përmes MSH-së, në përputhje me dispozitat e Nenit V të Kushteve të Përgjithshme dhe Skedulin 2 të kësaj Marrëveshje.

NENI V — HYRJA NË FUQI; PËRFUNDIMI

4.01. Afati i fundit i Hyrjes në fuqi është data nëntëdhjetë (90) ditë pas Datës së Nënshkrimit.

4.02. Për qëllime të Seksionit 10.05 (b) të Kushteve të Përgjithshme, data në të cilën do të përfundojnë detyrimet e Marrësit sipas kësaj Marrëveshjeje (përveç atyre që parashikojnë detyrimet e pagesës) është [njëzet vjet pas Datës së Nënshkrimit.

NENI V — PËRFQËSUESIT; ADRESAT

5.01. Përfaqësuesi i Marrësit është Ministri i vet i Financave, Punës dhe Transfereve, i cili, *ndër të tjera* mundet që në emër të Marrësit të dakordohet për çdo rishikim të dispozitave të përcaktuara në Skedulet e kësaj Marrëveshje, në përputhje me Seksionin 11,02 (b) të Kushteve të Përgjithshme.

5.02. Për qëllime të Seksionit 11.01 të Kushteve të Përgjithshme:

(a) adresa e Marrësit është:

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
Ndërtesa e re e Qeverisë
Rruga Nëna Terezë
10000 Prishtinë
Republika e Kosovës; dhe

(b) Adresa e postës elektronike të Marrësit është:

Faks:	E-mail
+383-38-213-113	dbnf.mf@rks-gov.net

5.03. Për qëllime të Seksionit 11.01 të Kushteve të Përgjithshme:

(a) Adresa e Asociacionit është:

Asociacioni Ndërkombëtar për Zhvillim
1818 H Street, N.W.
Washington, D.C. 20433
United States of America; dhe

(b) Adresa e postës elektronike të Asociacionit është:

Telex:	Faks:
248423 (MCI)	1-202-477-6391

DAKORDUAR më datën e nënshkrimit

REPUBLIKA E KOSOVËS

Nga

_____

Përfaqësuesi i autorizuar

Emri: _____

Titulli: _____

Data: _____

ASOCIACIONI NDËRKOMBËTAR PËR ZHVILLIM

Nga

_____

Përfaqësuesi i autorizuar

Emri: _____

Titulli: _____

Data: _____

SKEDULI 1

Përshkrimi i projektit

Objektivi i Projektit është forcimi i kapaciteteve institucionale dhe qeverisjes për cilësinë e kujdesit në sistemin e shëndetësisë të Kosovës.

Projekti përbëhet nga pjesët e mëposhtme:

Pjesa 1. Forcimi i pjesëve përbërëse të sistemit shëndetësor me rëndësi kyçe për cilësinë e kujdesit

1.1 Përmirësimi i ofrimit të shërbimeve

(a) Forcimi i qeverisjes për cilësinë e kujdesit nëpërmjet financimit të asistencës teknike dhe/ose trajnimit dhe ofrimit të mbështetjes me teknologji të informimit (TI), duke përfshirë pajisje, për: (i) Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës ("IKPSHK"), Shërbimin Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës ("SHSKUK") dhe MSH-në; (ii) Forumet Vjetore Rajonale dhe Kombëtare të Shëndetësisë; dhe (iii) Inspektoratin Shëndetësor.

(b) Forcimi i kapaciteteve institucionale për cilësinë e kujdesit nëpërmjet financimit të asistencës teknike dhe/ose trajnimit për: (i) zhvillimin, vlerësimin dhe miratimin e udhëzimeve klinike; (ii) zhvillimin e drejtimeve dhe protokolleve të kujdesit elektronik për të mundësuar integrimin e tyre në Sistemin Bazik Informativ Shëndetësor ("SBISH"); (iii) ofruesit e kujdesit shëndetësor për udhëzimet/protokollet dhe drejtimet e kujdesit klinik, auditimet klinike dhe praktikat më të mira të sigurimit të cilësisë/menaxhimit të cilësisë; (iv) zhvillimin e doracakut për treguesit e cilësisë, auditimin klinik dhe reagime për koordinatorët e cilësisë; dhe (v) punëtorët e KPSH-së, përfshirë tema që kanë të bëjnë me DHBGJ, dhunën në familje dhe mbështetjen për shëndetin psiko-social.

1.2 Zhvillimi i dhe zbatimi blerjeve strategjike për cilësi

Zhvillimi dhe zbatimi i elementeve kyçe për blerje strategjike për cilësinë e kujdesit nëpërmjet financimit të asistencës teknike për: (a) pilotin e Paketës së Përfitimeve për Barna Ambulatore ("PPBA"); (b) zhvillimin dhe zbatimin e një pagese të bazuar në raste për QKUK-un, duke filluar me trajtimin jashtë vendit dhe PSPK për KPSH; dhe (c) zbatimin e Ligjit për çmimin e produkteve medicinale.

1.3 Forcimi i kapaciteteve institucionale për shëndetësi publike dhe gatishmërisë dhe reagimit ndaj pandemive (GRP)

(a) Ulja e Rezistencës Antimikrobike ("RAM") dhe forcimi i Parandalimit dhe Kontrollit të Infeksioneve ("PKI") përmes financimit për: (i) pajisje dhe furnizime për objektet shëndetësore, materiale shpenzuese mjekësore dhe komplete testimi për laboratorët e shëndetësisë publike; (ii) pajisje dhe furnizime për mbikëqyrjen për RAM dhe infeksione të lidhura me kujdesin shëndetësor, duke përfshirë kostot për mostra ose panele të testimit të aftësisë; (iii) trajnim të ofruesve të kujdesit shëndetësor për vetëdijesimin për RAM dhe PKI në të gjitha nivelet e kujdesit, përfshirë trajtimin dhe këshillimin për sëmundje të transmetueshme seksualisht dhe lëndime fizike të të mbijetuarave të DHBGJ-së; (iv) konsulenca, punëtori, printim dhe shpërndarje të udhëzimeve për RAM; dhe (v) ngritjen e kapaciteteve për Programin për Mbikëqyrje Antimikrobike në spitale.

(b) Mbështetja e menaxhimit të mbeturinave shëndetësore (MMSH) nëpërmjet financimit për: (i) sigurim të pajisjeve të standardizuara mbrojtëse dhe furnizimeve dhe pajisjeve për grumbullimin e mbeturinave shëndetësore; (ii) ndërtim dhe/ose përshtatje të hapësirave të sigurta të ruajtjes (deponi) për mbeturinat infektive dhe të mprehta; (iii) ndërtim dhe/ose rinovim të infrastrukturës përcjellëse për trajtimin e mbeturinave shëndetësore; (iv) zëvendësim i pajisjeve të vjetruara (autoklava) për trajtimin e mbeturinave shëndetësore; (v) prokurim të automjeteve për transportin e mbeturinave shëndetësore; (vi) rehabilitim i një deponie qendrore ekzistuese për të shtuar hapësirë për mbeturinat farmaceutike, duke përfshirë dizajnin dhe monitorimin e punimeve; dhe (vii) trajnim për MMSH.

Pjesa 2. Zhvillimi i Sistemit të Integruar Informativ Shëndetësor ("SIISH")

2.1 Krijimi i pjesëve përbërëse themelore të SIISH-it

Krijimi i elementeve kritike për kornizën për Arkitekturën e Ndërmarrjeve ("AN") të Marrësit për zbatimin e sistemeve të shëndetësisë digjitale nëpërmjet financimit të asistencës teknike dhe/ose pajisjeve për: (a) zhvillimin e një kornize ligjore për ofrimin e transformuar të shërbimeve shëndetësore nëpërmjet përdorimit të sistemeve digjitale; (b) vlerësimin dhe dizajnin e standardeve dhe sistemeve për Menaxhim të të Dhënave Master ("MDHM"), siç janë regjistrat themelorë dhe sistemet e zakonshme të kodimit dhe klasifikimit; (c) dizajnin dhe zbatimin e shërbimeve për Shkëmbim të Informatave Shëndetësore ("SHISH"); (d) përmirësimin e platformave harduerike në lokacionet qendrore dhe në objektet shëndetësore; dhe (e) forcimin e kapacitetit të Marrësit për zbatim të shëndetësisë digjitale, duke përfshirë trajnimin e profesionistëve shëndetësorë dhe administratorëve teknikë të sistemeve digjitale.

2.2 Mbështetje e shëndetësisë digjitale për përmirësim në cilësinë e kujdesit

Zbatimi dhe përmirësimi i SBISH-it nëpërmjet financimit të asistencës teknike për: (a) futjen në përdorim të SBISH-it në të gjithë KPSH-në duke përfshirë finalizimin e mbulimit dhe zonimit të pacientëve; (b) përmirësimin e funksioneve të SBISH-it; dhe (c) përmirësimin e integrimit me sistemin për Referime elektronike dhe vendosjen e Termineve elektronike.

2.3 Zbatimi i sistemeve strategjike të SIISH-it

Ofrimi i asistencës teknike për: (a) zbatimin e një Sistemi Informativ të Menaxhimit Spitalor ("SIMS") për të gjitha spitalet e përgjithshme publike; (b) zbatimi i një Sistemi qendror Informativ Laboratorik ("SIL"); (c) forcimin e aftësive të IKSHPK-së për analitikën e të dhënave shëndetësore duke vendosur magazinën e të dhënave dhe duke përmirësuar ndërfaqet për transferim të të dhënave dhe analitikë të mençur; (d) përmirësimin e sistemit për mbikëqyrje dhe paralajmërim të hershëm; dhe (e) zhvillimin e një sistemi për e-Inspektime.

Pjesa 3. Menaxhimi i Projektit, Monitorimi dhe Vlerësimi

Mbështetje për menaxhimin dhe zbatimin e përgjithshëm të projektit, duke përfshirë funksionet fiduciare (prokurimi, menaxhimi financiar), auditimet, monitorimin dhe vlerësimin, pajtueshmërinë mjedisore dhe sociale dhe raportimin.

SKEDULI 2

Ekzekutimi i Projektit

Seksioni I. **Aranzhimet e Zbatimit**

A. Aranzhimet Institucionale.

1. Marrësi, nëpërmjet MSH-së, krijon, jo më vonë se tridhjetë (30) ditë nga Data e Hyrjes në Fuqi, dhe më pas do të mbajë gjatë gjithë kohës gjatë zbatimit të projektit, një Komitet të Lartë Menaxhues (KLM) për koordinimin dhe mbikëqyrjen e përgjithshme të projektit, të kryesuar nga MSH-ja dhe që përbëhet nga agjenci të ndryshme përgjegjëse si për koordinimin ashtu edhe për zbatimin teknik, siç përshkruhet më tej në Doracakun e Operacioneve të Projektit ("DOP").

2. Marrësi, nëpërmjet MSH-së, krijon, jo më vonë se gjashtëdhjetë (60) ditë nga Data e Hyrjes në Fuqi, dhe më pas e mban gjatë gjithë kohës gjatë zbatimit të projektit, një Komitet Drejtues për Shëndetësi Digjitale (KDSHD), përgjegjës për hartimin e politikave për shëndetësi digjitale dhe qeverisjen e të dhënave shëndetësore në kuadër të Pjesës 2 të Projektit, siç përshkruhet më tej në DOP.

3. Marrësi, nëpërmjet MSH-së, krijon, jo më vonë se tridhjetë (30) ditë nga Data e Hyrjes në Fuqi, dhe më pas do mbajë në funksionim, gjatë gjithë kohës gjatë zbatimit të projektit, një NJKP me strukturë, funksione dhe përgjegjësi të pranueshme për Asociacionin, siç parashikohet në DOP, duke përfshirë, *ndër të tjera*, sigurimin e mbështetjes për prokurimin, menaxhimin financiar dhe raportimin për përdorimin e fondeve të projektit, me resurse dhe staf (me kualifikime, përvojë dhe me terma të referencës) të kënaqshme për Asociacionin.

4. Marrësi, nëpërmjet MSH-së, siguron që NJKP-ja gjatë gjithë kohës gjatë zbatimit të projektit të jetë me staf adekuat me profesionistë të nevojshëm për të përmbushur funksionet e veta, duke përfshirë, *ndër të tjera*: (a) një Koordinator të Projektit; (b) një Specialist Prokurimi; (c) një Specialist për Menaxhim Financiar; (d) një Specialist për Monitorim dhe Vlerësim; (e) një koordinator për TI; (f) një Specialist Mjedisor dhe Social me orar të pjesshëm; dhe (g) një specialist për MMSH për periudhën e zbatimit të aktiviteteve për MMSH, siç përshkruhet më tej në DOP.

B. Doracaku i Operacioneve të Projektit

1. Marrësi, nëpërmjet MSH-së, jo më vonë se tridhjetë (30) ditë pas Datës së Hyrjes në Fuqi, e zhvillon dhe miraton, si dhe më pas e zbaton Projektin në pajtim me Doracakun e Operacionit të Projektit i cili përmban, *ndër të tjera*: (a) udhëzime dhe procedura të detajuara për zbatimin e Projektit, duke përfshirë krijimin e NJKP-së, strukturën, funksionet dhe përgjegjësitë e saj; administrimin dhe koordinimin e projektit; monitorimin dhe vlerësimin; menaxhimin financiar; prokurimin dhe kontabilitetin; dhe standardet mjedisore dhe sociale; (b) masat për zbutjen e korrupsionit dhe mashtrimit; (c) një mekanizëm për trajtimin e ankesave; (d) mbledhjen dhe përpunimin e të Dhënave Personale në përputhje me praktikën e mirë ndërkombëtare; dhe (e) aranzhime dhe procedura të tjera.

2. Përveç nëse Asociacioni dakordohet ndryshe, Marrësi, përmes MSH-së, nuk e cakton, ndryshon, shfuqizon ose të heqë, ose përndryshe të mos të zbatojë DOP-in ose ndonjë nga dispozitat e tij. Në rast të një konflikti mes DOP-it dhe dispozitave të kësaj Marrëveshje, do të mbizotërojnë dispozitat e kësaj Marrëveshje.

C. Standardet Mjedisore dhe Sociale

1. Marrësi, përmes MSH-së, siguron që Projekti të kryhet në përputhje me Standardet Sociale dhe Mjedisore, në një mënyrë të pranueshme për Asociacionin.

2. Pa kufizime sipas paragrafit 1 më lart, Marrësi, përmes MSH-së, siguron që Projekti zbatohet në përputhje me Planin e Përkushtimit Mjedisor dhe Social ("PPMS"), në një mënyrë të pranueshme për Asociacionin. Për këtë qëllim, Marrësi, përmes MSH-së, siguron që:

   (a) masat dhe veprimet e specifikuara në PPMS zbatohen me kujdesin e duhur dhe efikasitet, siç specifikohen më tej në PPMS;

   (b) janë të disponueshme fonde të mjaftueshme për të mbuluar kostot e zbatimit të PPMS-së;

   (c) mbahen politikat dhe procedurat dhe ruhet personeli i kualifikuar, me përvojë dhe në numër adekuat për ta zbatuar PPMS-në, siç parashikohet në PPMS; dhe

   (d) PPMS ose cilado dispozitë e tij, nuk ndryshohet, shfuqizohet, pezullohet ose hiqet, përveç kur Asociacioni dakordohet ndryshe me shkrim, siç specifikohet në PPMS, dhe siguron shpalosjen e PPMS-së të rishikuar.

3. Në rast të një konflikti mes PPMS-së dhe dispozitave të kësaj Marrëveshje, do të mbizotërojnë dispozitat e kësaj Marrëveshje.

4. Marrësi, përmes MSH-së, siguron që:

(a) merren të gjitha masat e nevojshme për të mbledhur, përpiluar dhe për t'i dorëzuar Asociacionit, përmes raporteve të rregullta, me shpeshtësinë e specifikuar në PPMS, dhe menjëherë në një raport ose raporte të veçanta nëse kërkohet nga Asociacioni, informacione për statusin e pajtueshmërinë me PPMS dhe instrumentet mjedisore dhe sociale të referuara në të, dhe të gjitha raportet e tilla janë në formë dhe substancë të pranueshme për Asociacionin, duke përcaktuar, *ndër të tjera*: (i) statusin e zbatimit të PPMS-së; (ii) kushte, nëse ka, të cilat ndërhyjnë ose kërcënojnë të ndërhyjnë në zbatimin e PPMS-së; dhe (ii) masat korrigjuese dhe parandaluese të marra ose që kërkohet të merren për t'i adresuar këto kushte; dhe

(b) e njofton menjëherë Asociacionin për çdo incident ose aksident në lidhje me Projektin ose që ka një ndikim në të, e cili ka, ose ka të ngjarë të ketë, një efekt të rëndësishëm negativ në mjedis, komunitetet e prekura, publikun ose punëtorët, në përputhje me PPMS-në, instrumentet mjedisore dhe sociale të referuara në të, si dhe me Standardet Sociale dhe Mjedisore.

5. Marrësi, përmes MSH-së, e krijon, reklamon, mban dhe operon një mekanizëm të qasshëm për ankesa, për të marrë dhe lehtësuar zgjidhjen e shqetësimeve dhe ankesave të qytetarëve të prekur nga Projekti, si dhe merr të gjitha masat e nevojshme dhe të përshtatshme për të zgjidhur ose për të lehtësuar zgjidhjen e këtyre shqetësimeve dhe ankesave, në një mënyrë të pranueshme për Asociacionin.

6. Marrësi, nëpërmjet MSH-së, siguron që të gjitha dokumentet e tenderit dhe kontratat për punimet ndërtimore sipas Projektit të përfshijnë detyrimin e kontraktorëve për: (a) pajtueshmëri me aspektet relevante të PPMS-së dhe instrumentet mjedisore dhe sociale të referuara në të; dhe (b) miratimin dhe zbatimin e kodeve të sjelljes që duhet t'u sigurohen të gjithë punëtorëve dhe të nënshkruhen prej tyre, duke detajuar masat për të adresuar risqet mjedisore, sociale, shëndetësore dhe të sigurisë, si dhe risqet e shfrytëzimit dhe abuzimit seksual, ngacmimit seksual dhe dhunës ndaj fëmijëve, siç janë të zbatueshme për këto punimeve ndërtimore të porositura ose të kryera në përputhje me kontratat në fjalë.

Seksioni II. <u>Monitorimi, Raportimi dhe Vlerësimi i Projektit</u>

1. Marrësi ia paraqet Asociacionit çdo Raport të Projektit jo më vonë se një (1) muaj pas përfundimit të secilit semestër kalendarik, duke mbuluar semestrin kalendarik.

2. Me përjashtim të rasteve kur kërkohet ose lejohet në mënyrë të qartë në përputhje me këtë Marrëveshje ose siç kërkohet në mënyrë të drejtpërdrejtë nga Asociacioni, në ndarjen e çdo informacioni, raporti ose dokumenti në lidhje me aktivitetet e

përshkruara në Skedulin 1 të kësaj Marrëveshje, Marrësi siguron që informacioni, raporti ose dokumenti i tillë nuk përfshin të Dhëna Personale.

Seksioni III. Tërheqja e të Ardhurave të Financimit

A. Të përgjithshme

Pa kufizim në dispozitat e Nenit II të Kushteve të Përgjithshme dhe në përputhje me Letrën e Disbursimit dhe Informacionit Financiar, Marrësi mund t'i tërheqë të ardhurat nga Financimi që të financojë Shpenzimet e Pranueshme në shumën e alokuar dhe, nëse është e zbatueshme, në përqindjen e përcaktuar në secilën Kategori të tabelës në vijim:

Kategoria	Shuma e Financimit të Alokuar (shprehur në EURO)	Përqindja e Shpenzimeve që do të Financohen (përfshirë Tatimet)
(1) Punime, mallra, shërbime jo këshilluese, shërbime këshilluese, kosto trajnimi dhe operacionale të Projektit	18.600.000	100%
GJITHSEJ SHUMA	**18.600.000**	

B. Kushtet e Tërheqjes; Periudha e Tërheqjes

1. Pavarësisht nga dispozitat e Pjesës A të këtij Seksioni, nuk do të bëhet asnjë tërheqje për pagesat e bëra përpara Datës së Nënshkrimit..

2. Data e Mbylljes është 31 marsi 2029.

SKEDULI 3

Skeduli i Shlyerjes

Data e Pagesës së Detyruar	Shuma e principalit të kredisë së ripagueshme (e shprehur si përqindje)*
Çdo 15 mars dhe 15 shtator:	
duke filluar nga 15 shtatori 2029, deri në dhe duke përfshirë 15 marsin 2049	**1.65%**
duke filluar nga 15 shtatori 2049, deri në dhe duke përfshirë 15 marsin 2054	**3.40%**

* Përqindjet përfaqësojnë përqindjen e shumës së principalit të Kredisë që duhet të shlyhet, përveç nëse Asociacioni mund të specifikojë ndryshe në pajtim me Seksionin 3.05 (b) të Kushteve të Përgjithshme.

SHTOJCA

Pjesa I. Përkufizimet

1. "RAM" nënkupton rezistencë antimikrobike ("RAM")

2. "Udhëzimet kundër Korrupsionit" janë, për qëllime të paragrafit 5 të Shtojcës së Kushteve të Përgjithshme, "Udhëzimet për Parandalimin dhe Luftimin e Mashtrimeve dhe Korrupsionit në Projektet e Financuara nga Huatë e IBRD-së dhe Kreditë dhe Grantet e IDA-s", të datës 15 tetor 2006, rishikuar në janar 2011 dhe më 1 korrik 2016.

3. Forumet Vjetore Rajonale dhe Kombëtare të Shëndetësisë nënkupton konferenca/punëtori/diskutime me palë të interesit, të cilat shërbejnë si platforma për diskutim, ndarje informacioni dhe vendimmarrje në lidhje me politikat, strategjitë dhe praktikat shëndetësore, si dhe për të nxitur angazhimin e formalizuar të qytetarëve, fuqizimin, si dhe për nxitjen e kërkesës për shërbime shëndetësore me cilësi të lartë.

4. "Programi për mbikëqyrje antimikrobike" nënkupton një program të koordinuar të Marrësit që promovon përdorimin e duhur të antimikrobikëve.

5. "Rregullimi i Bazës për Ngarkesën e Interesit" nënkupton rregullimin e bazës nga Asociacioni për Ngarkesën e Interesit për kreditë në monedhën e emërtimit të Kredisë, në fuqi në ora 12:01 në Uashington, DC, në datën në të cilën është miratuar Kredia nga Drejtorët Ekzekutivë të Asociacionit, dhe shprehet si përqindje pozitive ose negative në vit.

6. "Rregullimi i Bazës për Ngarkesën e Shërbimit" nënkupton rregullimin e bazës nga Asociacioni për Ngarkesën e Shërbimit për kreditë në monedhën e emërtimit të Kredisë, në fuqi në ora 12:01 në Uashington, DC, në datën në të cilën është miratuar Kredia nga Drejtorët Ekzekutivë të Asociacionit, dhe shprehet si përqindje në vit.

7. "SBISH" nënkupton Sistemin Bazik Informativ Shëndetësor në kuadër të qendrave të Kujdesit Parësor Shëndetësor (QKPSH);

8. "Kategori" nënkupton një kategori të përcaktuar në tabelën në Seksionin III.A të Skedulit 2 të kësaj Marrëveshje.

9. "PSPK" nënkupton pagesat sipas performancës për kapitacion, i cili është një mekanizëm pagese për ofruesit e kujdesit shëndetësor, në veçanti për KPSH-në, nëpërmjet të cilit ofruesit marrin një shumë të parashikueshme parash për të

mbuluar kostot e parashikueshme të të gjitha ose disa shërbimeve të kujdesit shëndetësor.

10. "KDSHD" nënkupton komitetin e referuar në Seksionin I.A.2 të Skedulit2 të kësaj Marrëveshje.

11. "Arkitektura e Ndërmarrjes" ("AN") nënkupton elemente kritike të mjedisit themelor për zbatimin e sistemeve të shëndetësisë digjitale, duke përfshirë, *ndër të tjera,* kornizën ligjor, dizajnin e sistemeve dhe standardeve të menaxhimit të të dhënave, dizajnin e shkëmbimeve të informacionit dhe platformat harduerike.

12. "Plani i Përkushtimit Mjedisor dhe Social" ose "PPMS" nënkupton planin e përkushtimit mjedisor dhe social për Projektin, i datës 2 prill 2024, siç mund të ndryshohet herë pas here i njëjti në përputhje me dispozitat e tij, i cili përcakton masat materiale dhe veprimet që Marrësi do të kryejë ose do të bëjë që të kryhen për të adresuar risqet dhe ndikimet e mundshme mjedisore dhe sociale të Projektit, duke përfshirë afatet kohore të veprimeve dhe masave, aranzhimet institucionale, të personelit, trajnimit, monitorimit dhe raportimit, dhe çdo instrument mjedisor dhe social që do të përgatitet në bazë të tij.

13. "Standardet Mjedisore dhe Sociale" ose "SMS" nënkuptojnë, kolektivisht: (i) "Standardin Mjedisor dhe Social 1: Vlerësimi dhe Menaxhimi i Risqeve dhe Ndikimeve Sociale dhe Mjedisore"; (ii) "Standardin Mjedisor dhe Social 2: Kushtet e Punësimit dhe të Punës"; (iii) "Standardin Mjedisor dhe Social 3: Efiçienca e Resurseve dhe Parandalimi dhe Menaxhimi i Ndotjes"; (iv) "Standardin Mjedisor dhe Social 4: Shëndeti dhe Siguria e Komunitetit"; (v) "Standardin Mjedisor dhe Social 5: Blerja e Tokës, Kufizimet në Përdorimin e Tokës dhe Zhvendosja e Pavullnetshme"; (vi) Standardin Mjedisor dhe Social 6: Ruajtja e Biodiversitetit dhe Menaxhimi i Qëndrueshëm i Resurseve Natyrore të Gjalla"; (vii) Standardin Mjedisor dhe Social 7: Komunitete tradicionale lokale historikisht pa shërbime nga popuj indigjenë/afrikanë sub-saharianë"; (viii) Standardin Mjedisor dhe Social 8: Trashëgimia kulturore"; (ix) "Standardin Social dhe Mjedisor 9: Ndërmjetësuesit Financiarë"; (x) "Standardin Social dhe Mjedisor 10: Angazhimi i Palëve të Interesit dhe Shpalosja e Informacionit"; në fuqi nga 1 tetorit 2018, siç janë botuar nga Asociacioni.

14. "DHBGJ" nënkupton dhunë në baza gjinore.

15. "Kushtet e Përgjithshme" nënkuptojnë "Kushtet e Përgjithshme të Asociacionit për Zhvillim Ndërkombëtar për Financimin e IDA-s, Financimin e Projektit Investues", të datës 14 dhjetor 2018 (rishikuar për herë të fundit më 15 korrik 2023).

16. "Inspektorati Shëndetësor" nënkupton njësinë në kuadër të MSH-së e cila është përgjegjëse për inspektimet në sektorin e shëndetësisë.

17. "SHISH" nënkupton shkëmbimi i informatave shëndetësore;

18. "SIMS" nënkupton Sistemi Informativ i Menaxhimit Spitalor.

19. "MMSH" nënkupton menaxhimi i mbeturinave shëndetësore.

20. "SIISH" nënkupton Sistemi i Integruar Informativ Shëndetësor.

21. "PKIU" nënkupton parandalimin dhe kontrollin e infeksioneve.

22. "SHKSUK" nënkupton Shërbimin Klinik Spitalor dhe Universitar të Kosovës, një rrjet i spitaleve të kujdesit dytësor dhe tretësor.

23. "Ligji për çmimin e produkteve medicinale" nënkupton ligjin e Marrësit Nr. 08/L-220 të datës 13 korrik 2023, publikuar në Gazetën Zyrtare më 1 gusht 2023.

24. "SIL" nënkupton Sistemin Informativ Laboratorik.

25. "MDHM" nënkupton Menaxhim të të Dhënave Master.

26. "MSH" nënkupton Ministrinë e Shëndetësisë të Marrësit, ose çdo pasardhës të saj.

27. "IKSHPK" nënkupton Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës ose çdo pasardhës të tij.

28. "Kosto operative" nënkupton shpenzime të arsyeshme shtesë të shkaktuara drejtpërdrejt për shkak të zbatimit, menaxhimit dhe monitorimit të Projektit nga Marrësi; kosto të tilla mund të përfshijnë, sipas rastit, dhe siç mund të dakordohet Asociacioni, auditimet e projektit, furnizimet e zyrës, marrje me qira të zyrës, marrje me qira të automjeteve, mirëmbajtje dhe riparim të pajisjeve të zyrës dhe komunikim, përkthim dhe interpretim (nuk mbulohen nga Trajnimi), tarifat e botimit, pronësia për të drejtat e pronësisë intelektuale, pagat e personelit të NJKP-së (por duke përjashtuar shërbimet e konsulentëve dhe pagat e zyrtarëve të shërbimit civil të Marrësit); dhe shpenzime të tjera të ndryshme të lidhura drejtpërdrejt me Projektin dhe të dakorduara ndërmjet Asociacionit dhe Marrësit. Këto Kosto Operative nuk përfshijnë shpenzimet e financuara nga IDA në kuadër të projekteve të tjera ose të financuara nga financues të tjerë.

29. "Paketa e Përfitimeve për Barna Ambulatore" ose "PPBA" nënkupton listën e barnave ambulatore që do të përfshihen në paketën e përfitimeve të sigurimit që do të menaxhohet nga Fondi i Sigurimeve Shëndetësore të Marrësit kur të futet në përdorim Sigurimi Shëndetësor Social.

30. "NJKP" nënkupton njësinë për koordinim të projektit që do të themelohet dhe mbahet nga Marrësi në kuadër të MSH-së, në përputhje me Seksionin I.A.3 të Skedulit 2 të kësaj Marrëveshje.

31. "Të dhëna personale" nënkupton çdo informacion në lidhje me një individ të identifikuar ose të identifikueshëm. Një individ i identifikueshëm është ai që mund të identifikohet me mjete të arsyeshme, direkt ose indirekt, duke iu referuar një atributi ose kombinimi të atributeve brenda të dhënave, ose kombinimi të të dhënave me informacione të tjera në dispozicion. Atributet që mund të përdoren për të identifikuar një individ të identifikueshëm, përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm në, emrin, numrin e identifikimit, të dhënat e vendndodhjes, identifikuesin online, metadatat dhe faktorët specifikë të identitetit fizik (përfshirë të dhëna biometrike), fiziologjik, gjenetik, mendor, ekonomik, kulturor ose shoqëror të një individi."

32. "QKPSH" nënkupton Qendër të Kujdesit Parësor Shëndetësor.

33. "Rregulloret e Prokurimit" nënkupton, për qëllime të paragrafit 85 të Shtojcës së Kushteve të Përgjithshme, "Rregulloret për Prokurim të Bankës Botërore për Huamarrësit e FPI-ve", të shtatorit 2023.

34. "Doracaku i Operacioneve të Projektit" ose "DOP" nënkupton doracakun e pranueshëm për Bankën dhe të referuar në Seksionin I.B të Skedulit 2 të kësaj Marrëveshje, dhe doracaku i tillë mund të ndryshohet kohë pas kohe me dakordimin paraprak me shkrim të Asociacionit.

35. "Data e Nënshkrimit" nënkupton datën më të vonë nga dy datat në të cilat Marrësi dhe Asociacioni e nënshkruajnë këtë Marrëveshje, dhe ky përkufizim zbatohet për të gjitha referencat për "datën e Marrëveshjes së Financimit" në Kushtet e Përgjithshme.

36. "Komiteti i Lartë për Menaxhim" ose "KLM" nënkupton komitetin e referuar në Seksionin I.A.1 të Skedulit 2 të kësaj Marrëveshje.

37. "Trajnim" nënkupton shpenzimet e arsyeshme që lidhen me trajnimin në kuadër të Projektit, duke përfshirë udhëtimet studimore, kurset e trajnimit, seminaret, punëtoritë dhe aktivitetet e tjera të trajnimit, të cilat nuk përfshihen në kontratat e ofruesve të shërbimeve, duke përfshirë kostot e materialeve të trajnimit, hapësirës dhe pajisjeve me qira, udhëtimet, kostot e akomodimit dhe mëditjes së të trajnuarve dhe trajnerëve, tarifat e trajnerëve dhe kosto të ndryshme të lidhura me trajnimin.